

# NGA ARSIMI TEK PUNËSIMI

## KUKËSI SI LABORATOR I MOSPËRPTHJES

Analizë e mospërputhjes midis arsimit  
dhe tregut të punës në Shqipëri

### INFORMACION I KUFIZUAR

Vendime për studime  
pa orientim të  
qartë profesional



### TREGU I KUFIZUAR

Vende pune të pakta  
të përshtatura me  
profilin e diplomuar

## GJETJET KRYESORE NGA STUDIMI



**72.3%**

e të anketuarve  
mendojnë se  
universiteti nuk i ka  
përgatitur mjaftueshëm  
për tregun e punës



**52.3%**

punojnë jashtë  
profilit të  
studimeve



**75.4%**

do të  
rikualifikoheshin  
për një profesion  
tjetër



**56.9%**

kanë konsideruar  
emigracionin



**65**

ANKETA



**8**

INTERVISTA



TË DHËNA  
DYTËSORE  
KOMBËTARE DHE  
NDËRKOMBËTARE

**Nga Arsimi tek Punësimi:**  
**Kukësi si laborator i mospërputhjes midis arsimit dhe tregut të punës në Shqipëri**  
Dr. Rifat Demalija

Kukës, Maj 2026

## Abstrakt

Mospërputhja midis arsimit dhe tregut të punës në Shqipëri përbën një problem strukturor që shkon përtej zgjedhjeve individuale të karrierës. Ky studim argumenton se hendeku midis studimeve dhe punësimit prodhohet nga ndërveprimi i dobët midis orientimit të hershëm profesional, sistemit arsimor dhe strukturës së tregut të punës, duke krijuar tranzicion të pasigurt nga arsimi drejt integritit profesional.

Analiza mbështetet në 65 anketa dhe 8 intervista gjysmë të strukturuar, të kombinuara me të dhëna dytësore nga raporte kombëtare dhe ndërkombëtare mbi tranzicionin arsim - punësim. Kukësi përdoret si rast analitik për të shqyrtuar mënyrën se si kufizimet ekonomike dhe mungesa e diversifikimit të tregut të punës ekspozojnë më qartë dobësitë e modelit kombëtar të integritit profesional.

Gjetjet tregojnë se shumica e të anketuarve kanë marrë vendime për studimet në kushte informacioni të kufizuar mbi tregun e punës, ndërkohë që 72.3% e tyre e perceptojnë universitetin si të pamjaftueshëm në përgatitjen praktike dhe orientimin profesional. Paralelisht, tregu vendor i punës konsiderohet i kufizuar në kapacitetin e tij për të përthithur profilet e diplomuara. Si rezultat, një pjesë e konsiderueshme e individëve që punojnë jashtë profilit, shfaqin gatishmëri për rikualifikim ose e konsiderojnë emigrimin si mekanizëm përshtatjeje profesional dhe ekonomik.

Studimi sugjeron se problemi nuk lidhet vetëm me cilësinë e zgjedhjeve individuale, por me mungesën e koordinimit funksional midis orientimit të karrierës, arsimit dhe zhvillimit ekonomik. Në këtë kuptim, Kukësi nuk trajtohet si përjashtim lokal, por si një laborator që ekspozon më qartë tendencat dhe dobësitë strukturore të tranzicionit nga arsimi në punësim në Shqipëri.

*Fjalë kyçe:* arsimi, tregu i punës, orientimi i karrierës, mospërputhja e aftësive, punësimi, emigrimi, Kukësi, Shqipëria.

## Hyrja

Tranzicioni nga arsimi drejt tregut të punës mbetet një nga sfidat më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri. Të dhënat e raportuara nga INSTAT<sup>1</sup> tregojnë se papunësia rinore për grupmoshën 15 - 24 vjeç vazhdon të mbetet 22.3 % dukshëm më e lartë se niveli i përgjithshëm i papunësisë 8.1%, ndërsa integritimi i të rinjve në tregun e punës karakterizohet nga pasiguri, informalitet dhe mospërputhje midis aftësive të fituara dhe kërkesave të ekonomisë. Në mënyrë të ngjashme, analiza e International Labour Organization<sup>2</sup> (ILO) evidenton se të rinjtë në

<sup>1</sup> INSTAT, *Labour Force Survey (LFS)*, 2025

<sup>2</sup> ILO, *Global Employment Trends for Youth 2024*

ekonomitë në tranzicion përballen me rrezik më të lartë të punësimit jo-stabël, mospërputhjes profesionale dhe emigrimit ekonomik<sup>3</sup>.

Në këtë kontekst, një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve në Shqipëri përballen me vështirësi në sigurimin e punësimit sipas profilit të studimeve, ndërkohë që edhe ata që punësohen në profesionin e tyre shpesh përballen me mungesë stabiliteti, paga të ulëta ose perspektivë të kufizuar zhvillimi profesional. Për pasojë, rikualifikimi, devijimi nga profesioni dhe emigrimi janë shndërruar në mekanizma të zakonshëm përshtatjeje ndaj kufizimeve të tregut të punës.

Ky fenomen shpesh interpretohet si rezultat i zgjedhjeve individuale të gabuara. Megjithatë, një qasje e tillë nuk arrin të shpjegojë kushtet në të cilat ndërtohen këto zgjedhje. Vendimmartja për studimet zhvillohet shpesh në mungesë informacioni mbi tregun e punës dhe me orientim të kufizuar profesional, ndërkohë që sistemi arsimor dhe struktura ekonomike nuk arrijnë të krijojnë mekanizma efektiv integrimi profesional. Për pasojë, zgjedhjet individuale mbeten formalisht autonome, por strukturalisht të kushtëzuara.

Në këtë kuadër, Kukësi paraqet një rast veçanërisht domethënës për analizë. Për shkak të tregut të kufizuar të punës, emigrimit të lartë dhe mundësive të reduktuara ekonomike, rajoni e ekspozon më qartë ndërveprimin midis orientimit të karrierës, arsimit dhe tregut të punës. Në vend që të trajtohet si një problem lokal apo periferik, Kukësi përdoret në këtë studim si një laborator i fenomeneve kombëtare dhe si një prove e funksionimit të sistemit të tranzicionit nga arsimi në punësim në Shqipëri.

Ky studim synon të analizojë faktorët që prodhojnë mospërputhjen midis studimeve dhe punësimit, duke u fokusuar në marrëdhënien ndërmjet orientimit të karrierës, sistemit arsimor dhe strukturës së tregut të punës. Analiza mbështetet në të dhëna të mbledhura përmes anketave dhe intervistave gjysmë të strukturuar, të kombinuara me statistika dhe raporte kombëtare e ndërkombëtare mbi tranzicionin arsim - punësim, punësimin dhe emigrimin.

## **Metodologjia**

Ky studim përdor qasje eksploruese dhe kombinon të dhëna parësore me të dhëna dytësore për të analizuar mospërputhjen midis arsimit dhe tregut të punës në Shqipëri.

Të dhënat parësore janë mbledhur përmes 65 anketave online dhe 8 intervistave gjysmë të strukturuar me individë me arsim të lartë dhe eksperiencë të ndryshme profesionale, kryesisht nga Qarku i Kukësit. Pyetësi është fokusuar në disa dimensione kryesore të tranzicionit nga arsimi në punësim, duke përfshirë:

- procesin e zgjedhjes së studimeve,
- nivelin e informacionit mbi tregun e punës,
- perceptimin mbi përgatitjen universitare,
- punësimin sipas profilit,
- gatishmërinë për rikualifikim,

---

<sup>3</sup> ILO, *School-to-Work Transition Surveys*

- dhe emigrimin si alternativë profesionale.

Intervistat gjysmë të strukturuar janë përdorur për të thelluar interpretimin e të dhënave sasiore dhe për të identifikuar mënyrën se si individët e përjetojnë tranzicionin nga arsimi drejt integritit profesional.

Të dhënat dytësore përfshijnë statistika dhe raporte nga INSTAT, OECD, ILO, ETF (European Training Foundation) dhe burime të tjera institucionale mbi: papunësinë rinore, tranzicionin arsim-punësim, mospërputhjen e aftësive, strukturën e tregut të punës, dhe emigrimin e të rinjve.

Analiza zhvillohet në tre nivele të ndërlidhura:

1. niveli individual, i lidhur me vendimmarrjen për studime dhe pritshmëritë profesionale;
2. niveli institucional, i lidhur me rolin e sistemit arsimor dhe orientimit të karrierës;
3. dhe niveli strukturor, i lidhur me kapacitetin e tregut të punës për të absorbuar kapitalin njerëzor.

Kukësi përdoret si rast ilustrues për shkak të karakteristikave ekonomike dhe demografike që e bëjnë më të dukshëm ndërveprimin midis këtyre faktorëve. Studimi nuk synon përfaqësim statistikor kombëtar, por identifikimin e modeleve, tendencave dhe mekanizmave strukturor që ndikojnë tranzicionin nga arsimi në punësim.

## **Konteksti kombëtar**

Mospërputhja midis arsimit dhe tregut të punës në Shqipëri nuk përfaqëson një fenomen të izoluar në nivel vendor, por një problem strukturor që reflektohet në disa tregues kombëtarë të lidhur me papunësinë rinore, punësimin sipas profilit dhe emigrimin e të rinjve.

Pavarësisht rritjes së aksesit në arsimin e lartë gjatë dy dekadave të fundit, tranzicioni nga universiteti drejt tregut të punës mbetet i vështirë për një pjesë të konsiderueshme të të diplomuarve. Të dhënat e INSTAT<sup>4</sup> tregojnë se papunësia rinore për grupmoshën 15 - 24 vjeç me 22.3 % në Shqipëri vazhdon të mbetet dukshëm më e lartë se niveli i përgjithshëm i papunësisë 8.1%, duke reflektuar vështirësitë e integritit profesional të të rinjve në tregun e punës.

Në të njëjtën kohë, raportet e institucioneve ndërkombëtare kanë evidentuar vazhdimisht hendekun midis aftësive të prodhuara nga sistemi arsimor dhe kërkesave reale të ekonomisë. Sipas analizave të European Training Foundation, 45-50% e të diplomuarve në Shqipëri punojnë jashtë profilit të studimeve të tyre, duke sugjeruar mospërputhje të vazhdueshme midis ofertës arsimore dhe strukturës së tregut të punës<sup>5</sup>.

Problemi bëhet edhe më kompleks në rajonet me zhvillim ekonomik më të kufizuar, ku tregu lokal nuk krijon mjaftueshëm vende pune të profilizuara dhe ku mundësitë për integrim

---

<sup>4</sup> [Punësimi dhe papunësia](#) INSTAT, 2025

<sup>5</sup> European Training Foundation (ETF), *Education, Skills and Employment — Trends and Developments: An ETF Cross-Country Monitoring Report*, 2025

profesional mbeten të reduktuara. Në këto kushte, emigrimi shfaqet jo vetëm si zgjedhje personale, por si mekanizëm përshtatjeje ekonomik dhe profesional. Sipas analizave të OECD<sup>6</sup>, emigrimi i të rinjve lidhet ngushtë me mungesën e mundësive të punësimit cilësor dhe me mospërputhjen e aftësive me tregun.

Të dhënat demografike dhe raportet mbi migracionin tregojnë se të rinjtë përbëjnë pjesën më aktive të emigracionit shqiptar, ndërsa largimi i kapitalit njerëzor lidhet ngushtë me mungesën e perspektivës profesionale dhe ekonomike në vend.

Në këtë kuadër, problematika e mospërputhjes midis arsimit dhe tregut të punës nuk mund të reduktohet vetëm në nivelin e zgjedhjeve individuale. Ajo lidhet me:

- mungesën e orientimit të hershëm të karrierës,
- dobësitë e sistemit arsimor në përgatitjen praktike dhe profesionale,
- mungesën e koordinimit me nevojat reale të tregut,
- dhe kapacitetin e kufizuar të ekonomisë për të përthithur kapitalin njerëzor të prodhuar.

Kukësi nuk përfaqëson një devijim nga ky realitet kombëtar. Përkundrazi, për shkak të kufizimeve më të forta ekonomike dhe tregut më të ngushtë të punës, ai shërben si një rast ku dobësitë strukturore të sistemit shqiptar bëhen më të dukshme dhe më të matshme.

## **Gjetjet**

### **1. Vendimmarrja për studime zhvillohet shpesh në kushte informacioni të kufizuar**

Gjetjet e mëposhtme bazohen në analizën e 65 anketave dhe 8 intervistave gjysmë të strukturuara, të kombinuara me të dhëna dytësore mbi tregun e punës dhe tranzicionin arsim - punësim në Shqipëri.

Të dhënat e mbledhura tregojnë se 87.7% e të anketuarve kanë marrë vendime për studimet universitare pa pasur informacion të mjaftueshëm mbi tregun e punës dhe perspektivat reale profesionale.

Sikurse tregohet në Figurën 1. vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve deklarojnë se kanë pasur informacion të qartë mbi tregun e punës në momentin e zgjedhjes së studimeve, ndërsa shumica raportojnë se kanë pasur pak ose aspak informacion. Kjo mbështet argumentin se procesi i orientimit të karrierës mbetet i dobët, veçanërisht në fazat para-universitare.

---

<sup>6</sup> [Skills cluster: Economic Convergence Scoreboard for the Western Balkans 2025 | OECD](#)




Figura 1.

7

Megjithëse pjesa më e madhe e të anketuarve e konsiderojnë zgjedhjen e studimeve si vendim personal dhe familjar (Figura 2.), analiza e përgjigjeve tregon se kjo autonomi zhvillohet në kushte të kufizuara informacioni dhe orientimi profesional. Në praktikë, individët marrin vendime të rëndësishme për karrierën pa pasur akses të mjaftueshëm në:

- informacion mbi kërkesat reale të tregut,
- perspektivat e punësimit,
- ndryshimet sektoriale,
- apo fleksibilitetin e profileve profesionale.




Figura 2.

8

Në këtë kuptim, zgjedhja mund të jetë formalisht individuale, por strukturalisht e kushtëzuar.

Gjetjet nxjerrin në pah gjithashtu se ndikimi familjar dhe perceptimet sociale vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm në orientimin arsimor. Në mungesë të mekanizmave funksional të këshillimit profesional, vendimmarrja mbështetet shpesh në:

- perceptimet mbi ‘degët e mira’,
- statusi social i profesioneve,
- sugjerimet familjare,
- apo pritshmëritë subjektive për tregun.

<sup>7</sup> Anketa e zhvilluar për këtë studim, Maj 2026


<sup>8</sup> Anketa e zhvilluar për këtë studim, Maj 2026

Kjo rrit probabilitetin që zgjedhjet arsimore të mos lidhen me realitetin ekonomik dhe profesional afatgjatë.

## 2. Sistemi arsimor nuk funksionon si mekanizëm korigjues i mospërputhjes

Në teori, sistemi arsimor duhet të funksionojë si mekanizëm që redukton hendekun midis zgjedhjeve fillestare të individëve dhe kërkesave reale të tregut të punës. Megjithatë, gjetjet e këtij studimi sugjerojnë se universiteti shpesh nuk arrin ta kryejë këtë funksion në mënyrë efektive.

Sikurse evidentohet në Figurën 3, 72.3% e të anketuarve deklarojnë se universiteti nuk i ka përgatitur mjaftueshëm për tregun e punës. Kjo tregon se problemi nuk lidhet vetëm me momentin e zgjedhjes së studimeve, por vazhdon edhe gjatë procesit universitar.



Në vend që të korigjojë mungesën fillestare të informacionit dhe orientimit profesional, sistemi arsimor shpesh e riprodhon atë përmes:

- përgatitjes kryesisht teorike,
- lidhjeve të dobëta me tregun e punës,
- praktikave profesionale të kufizuara,
- mungesës së orientimit të karrierës,
- dhe bashkëpunimit të pamjaftueshëm me sektorin privat.

Si rezultat, një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfundojnë studimet pa krijuar një lidhje të qartë midis profilit akademik dhe integritimit profesional.

Ky hendek bëhet edhe më i dukshëm në profile ku tregu i punës në nivel vendor është i kufizuar ose ku universiteti nuk arrin të ndërtojë mekanizma tranzicioni drejt punësimit. Në këto kushte, diploma shpesh funksionon më shumë si kualifikim formal sesa si instrument integrimi profesional.

Të dhënat tregojnë gjithashtu se mospërputhja prek fusha të ndryshme, përfshirë profilet:

<sup>9</sup> Anketa e zhvilluar për këtë studim, Maj 2026

- Shkenca Sociale dhe Juridike
- Ekonomi, Biznes dhe Financë,
- Edukim dhe Mësuesi,
- Teknologji dhe Inxhinieri
- Bujqësi, Mjedis dhe Ushqim
- Industri kreative dhe profesione specifike


Këta tregues na sjellin në vëmendje se problemi nuk kufizohet në një degë të vetme, por lidhet më gjerësisht me mënyrën se si organizohet tranzicioni nga arsimit drejt tregut të punës.

Në këtë kuptim, universiteti nuk shfaqet vetëm si institucion arsimor, por si hallkë e ndërmjetme në një sistem më të gjerë koordinimi midis arsimit dhe ekonomisë.

### 3. Kufizimet strukturore të tregut të punës

Gjetjet e studimit tregojnë se mospërputhja midis studimeve dhe punësimit nuk lidhet vetëm me zgjedhjet individuale apo me funksionimin e sistemit arsimor, por edhe me kapacitetin real të tregut të punës për të absorbuar kapitalin njerëzor të prodhuar.

Të dhënat e paraqitura në Figurën 4, tregojnë se 66.2% e të anketuarve e perceptojnë tregun vendor të punës si shumë të kufizuar, ndërsa 20% deklarojnë se tregu nuk ofron mundësi reale punësimi sipas profilit. Kjo sugjeron se, edhe në rastet kur individët posedojnë kualifikim të përshtatshëm, integrimi profesional mbetet i vështirë për shkak të strukturës së ekonomisë lokale dhe rajonale.



Në rajone si Kukësi, tregu i punës karakterizohet nga:

- diversifikim i ulët ekonomik
- numër i kufizuar sektorësh aktiv,
- dominim i punësimit me produktivitet të ulët,
- mungesë e vendeve të profilizuara,
- dhe mundësi të reduktuara për zhvillim profesional afatgjatë.

<sup>10</sup> Anketa e zhvilluar për këtë studim, Maj 2026

Në këto kushte, hendeku midis diplomimit dhe punësimit bëhet më i dukshëm, pasi oferta arsimore prodhon profile profesionale që ekonomia vendore nuk arrin t'i përthithë në mënyrë efektive. Të dhënat e paraqitura në Figurën 5, reflektojnë përgjigjet e të anketuarve lidhur punësimin në profilin e studimeve. Kjo situatë reflekton edhe strukturën e ekonomisë shqiptare, e cila mbetet e përqendruar në sektorë me produktivitet relativisht të ulët dhe kapacitet të kufizuar për përthithjen e profileve të specializuara.




Figura 5.

11

Ky fenomen nuk kufizohet vetëm në mungesën e vendeve të punës. Edhe kur punësimi ekziston, ai shpesh nuk lidhet me profilin e studimeve, nuk ofron stabilitet ekonomik, ose nuk krijon perspektivë afatgjatë zhvillimi profesional. Për pasojë, individët përballen me nevojën për ndryshim profesioni, rikualifikim, punësim informal, ose emigrim.

Në këtë kuptim, tregu i punës nuk funksionon si mekanizëm integruar i kapitalit njerëzor, por si faktor që shpesh e shtyn individin drejt adaptimit të detyruar profesional.

Kufizimet strukturore të tregut bëhen edhe më të rëndësishme kur analizohen në raport me profilet e studimit të të anketuarve. Edhe fusha që teorikisht konsiderohen me potencial më të lartë punësimi, si teknologjia, inxhinieria apo ekonomia, përballen me vështirësi integrimi në zona me bazë të kufizuar ekonomike.

Kjo tregon se problemi nuk lidhet vetëm me zgjedhjet e individëve apo cilësinë e diplomës, por me mungesën e koordinimit midis:

- ofertës arsimore,
- zhvillimit ekonomik
- dhe strukturës reale të tregut të punës.

#### 4. Rikualifikimi dhe emigrimi si mekanizma adaptimi

Gjetjet e studimit tregojnë se, përballë kufizimeve të tregut të punës dhe mospërputhjes midis arsimit dhe ekonomisë, individët zhvillojnë forma të ndryshme adaptimi profesional.


<sup>11</sup> Anketa e zhvilluar për këtë studim, Maj 2026

Sikurse evidentohet në Figurën 6, gatishmëria e 75.4% e të anketuarve për t'u rikualifikuar në një profesion tjetër shprehet dukshëm, edhe në rastet kur aktualisht punojnë në profilin e studimeve të tyre. Kjo sugjeron se përputhja formale midis diplomës dhe punësimit nuk garanton domosdoshmërisht stabilitet profesional, siguri ekonomike apo perspektivë afatgjatë zhvillimi.



Në këtë kuptim, rikualifikimi nuk duhet pa vetëm si dëshirë për ndryshim karriere, por si tregues i fleksibilitetit të detyruar profesional në një treg pune të paqëndrueshëm dhe me kapacitet të kufizuar absorbues.

Të dhënat në Figurën 7, tregojnë gjithashtu se emigrimi vazhdon të perceptohet si një nga alternativat kryesore për përmirësimin e perspektivës ekonomike dhe profesionale. 56.9% e të anketuarve deklarojnë se e kanë konsideruar emigrimin, ndërsa 16.9% kanë emigruar tashmë.



Kjo sugjeron se emigrimi nuk funksionon vetëm si zgjedhje individuale apo aspiratë personale, por si mekanizëm adaptimi ndaj:

- mungesës së mundësive profesionale,
- kufizimeve të tregut lokal,
- pasigurisë ekonomike,

<sup>12</sup> Anketa e zhvilluar për këtë studim, Maj 2026

<sup>13</sup> Anketa e zhvilluar për këtë studim, Maj 2026

- dhe pamundësisë për integrim të qëndrueshëm sipas profilit.

Rajonet me treg pune më të kufizuar, si Kukësi, presioni për përshtatje bëhet edhe më i fortë. Në mungesë të alternativave profesionale vendore, individët përballen shpesh me devijim nga profesioni, rikualifikim, punësim informal, ose largim nga vendi.

Në këtë aspekt, emigrimi dhe rikualifikimi nuk përfaqësojnë vetëm vendime individuale, por simptoma të një sistemi ku koordinimi midis orientimit profesional, arsimit dhe zhvillimit ekonomik mbetet i dobët.

Gjetjet përforcojnë argumentin se problemi kryesor nuk lidhet vetëm me faktin nëse individët punojnë ose jo, por me cilësinë, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e integritit të tyre profesional.

### **Mospërputhja si problem koordinimi strukturor**

Gjetjet e këtij studimi sugjerojnë se mospërputhja midis arsimit dhe tregut të punës në Shqipëri nuk mund të shpjegohet përmes një faktori të vetëm apo të reduktohet në nivelin e zgjedhjeve individuale. Përkundrazi, analiza tregon se ky fenomen prodhohet nga ndërveprimi i dobët midis orientimit të karrierës, sistemit arsimor dhe strukturës së tregut të punës.

Në nivel individual, të dhënat tregojnë se shumica e të anketuarve marrin vendime për studimet universitare në kushte informacioni të kufizuar mbi tregun e punës. Megjithëse zgjedhja perceptohet si personale, mungesa e orientimit profesional dhe e mekanizmave të këshillimit e kufizon ndjeshëm cilësinë e kësaj autonomie. Si rezultat, individët ndërtojnë pritshmëri profesionale pa pasur informacion të plotë mbi mundësitë reale të integritit në tregun e punës.

Në nivel institucional, universiteti nuk arrin gjithmonë të funksionojë si mekanizëm korrigjues i këtij hendeku fillestar. Përgatitja teorike, lidhjet e dobëta me tregun, mungesa e praktikave efektive profesionale dhe orientimi i kufizuar i karrierës kontribuojnë në vazhdimësinë e mospërputhjes midis diplomimit dhe integritit profesional.

Në nivel strukturor, ekonomia shqiptare dhe veçanërisht tregjet vendore të punës në rajone si Kukësi, karakterizohen nga kapacitete të kufizuara për të përthithur kapitalin njerëzor të prodhuar nga sistemi arsimor. Edhe individët me kualifikime të përshtatshme përballen me mungesë të vendeve të profilizuara, pasiguri profesionale dhe mundësi të kufizuara zhvillimi.

Në këtë kuptim, problemi nuk qëndron vetëm te arsimit apo vetëm te ekonomia, por tek mungesa e koordinimit funksional midis tyre.

Mospërputhja krijohet përmes një cikli strukturor ku:

- individët zgjedhin në kushte informacioni të kufizuar,
- sistemi arsimor nuk e korrigjon hendekun,
- tregu i punës nuk arrin të absorbojë kapitalin njerëzor,
- dhe individët adaptohen përmes rikualifikimit, devijimit profesional ose emigrimit.

Kjo e bën të pamjaftueshme qasjen që e trajton problemin vetëm si përgjegjësi individuale. Edhe pse individët mbajnë rol në procesin e vendimmarrjes, cilësia dhe efektiviteti i këtyre vendimeve ndikohen drejtpërdrejt nga kushtet strukturore në të cilat ato merren.

Në këtë kuadër, Kukësi nuk përfaqëson një rast të izoluar lokal, por një 'laborator' ku dobësitë ekzistuese të sistemit kombëtar bëhen më të dukshme për shkak të kufizimeve më të forta ekonomike dhe profesionale. Rajoni nuk prodhon një problem të ndryshëm nga pjesa tjetër e Shqipërisë; ai ekspozon më qartë intensitetin e problemeve ekzistuese të koordinimit midis arsimit dhe ekonomisë.

Gjetjet sugjerojnë se pa reforma që lidhin orientimin profesional, sistemin arsimor dhe zhvillimin ekonomik, Shqipëria rrezikon të vazhdojë:

- prodhimin e kapitalit njerëzor që nuk përputhet me nevojat reale të tregut,
- rritjen e fleksibilitetit të detyruar profesional,
- dhe largimin e të rinjve përmes emigrimit.

### **Kufizimet e studimit**

Ky studim ka karakter eksplorues dhe nuk synon përfaqësim statistikor kombëtar. Kampioni prej 65 anketash dhe 8 intervistash gjysmë të strukturuar është fokusuar kryesisht në individë nga Qarku i Kukësit dhe synon identifikimin e tendencave, perceptimeve dhe mekanizmave që ndikojnë tranzicionin nga arsimi në punësim.

Për këtë arsye, gjetjet nuk duhet të interpretohen si tregues përfundimtar për të gjithë të rinjtë e diplomuar në Shqipëri, por si evidencë analitike mbi mënyrën se si ndërveprojnë orientimi profesional, sistemi arsimor dhe struktura e tregut të punës në kontekste me mundësi të kufizuara ekonomike.

Në të njëjtën kohë, përdorimi i Kukësit si rast ilustrues përbën një zgjedhje të qëllimshme metodologjike. Rajoni nuk trajtohet si përjashtim nga realiteti kombëtar, por si një kontekst ku kufizimet strukturore të tranzicionit nga arsimi në punësim bëhen më të dukshme dhe më të matshme.

Studimi mbështetet kryesisht në perceptimet dhe eksperiencat e të anketuarve, të cilat mund të ndikohen nga faktorë subjektiv, eksperiencia individuale dhe konteksti socio-ekonomik. Megjithatë, kombinimi i të dhënave parësore me statistika dhe raporte kombëtare e ndërkombëtare synon të reduktojë këtë kufizim dhe të krijojë një interpretim më të gjerë strukturor të fenomenit.

### **Rekomandime**

Adresimi i mospërputhjes midis arsimit dhe tregut të punës kërkon ndërhyrje të koordinuara në tre nivele kryesore: orientimin e karrierës, sistemin arsimor dhe zhvillimin ekonomik. Gjetjet sugjerojnë se ndërhyrjet e izoluar nuk janë të mjaftueshme nëse nuk krijohet koordinim funksional midis këtyre hallkave.

### 1. Reformim i orientimit të hershëm të karrierës

Gjetjet tregojnë se shumica e individëve zgjedhin studimet universitare me informacion të kufizuar mbi tregun e punës. Për këtë arsye, orientimi profesional duhet të fillojë më herët sesa në fund të shkollës së mesme.

Rekomandohet:

- integrimi gradual i orientimit të karrierës në arsimin 9-vjeçar;
- identifikimi i hershëm i interesave, aftësive dhe prirjeve individuale;
- këshillim sistematik mbi profesionet, tregun e punës dhe alternativat e arsimit profesional;
- informim periodik mbi sektorët me kërkesë më të lartë në treg;
- përfshirje më aktive e prindërve në procesin e orientimit.

### 2. Forcimi i rolit të universiteteve si ura tranzicioni drejt punësimit

Universiteti duhet të funksionojë jo vetëm si institucion diplomimi, por edhe si mekanizëm tranzicioni drejt tregut të punës, për të reduktuar hendekun midis diplomimit dhe integritit profesional, jo ta riprodhojë atë.

Rekomandohet:

- funksionalizimi real i zyrave të karrierës;
- praktika profesionale të detyrueshme dhe të monitoruara;
- partneritete aktive universitet - biznes;
- përditësim periodik i kurrikulave sipas zhvillimeve të tregut;
- monitorim i punësimit të të diplomuarve sipas profileve;
- integrim më i madh i aftësive praktike, digjitale dhe ndërdisiplinore.

### 3. Ndërtimi i mekanizmave kombëtarë për parashikimin e tregut të punës

Mungesa e koordinimit midis arsimit dhe ekonomisë lidhet edhe me mungesën e analizave të vazhdueshme mbi nevojat reale të tregut të punës.

Rekomandohet:

- krijimi i mekanizmave kombëtarë për parashikimin e tregut të punës;
- analiza periodike sektoriale mbi profesionet me kërkesë në rritje;
- koordinim institucional ndërmjet:
  - o Ministrisë së Arsimit,
  - o Ministrisë së Ekonomisë,
  - o universiteteve,
  - o sektorit privat,
  - o dhe institucioneve të punësimit;

- publikim transparent i të dhënave mbi punësimin sipas profileve të studimit.

#### 4. Politika rajonale për zona me treg të kufizuar pune

Rajone si Kukësi kërkojnë politika më specifike për shkak të kufizimeve strukturore të tregut lokal.

Rekomandohet:

- politika për diversifikim ekonomik rajonal;
- mbështetje për sipërmarrjen rinore dhe profesionet digjitale;
- programe lokale rikualifikimi;
- stimulim për bizneset që punësojnë të rinj sipas profilit;
- politika për reduktimin e largimit të kapitalit njerëzor.

#### 5. Rikualifikimi dhe fleksibiliteti profesional si nevojë strukturore

Rekomandohet:

- programe të vazhdueshme aftësimi dhe rikualifikimi;
- promovim i aftësive digjitale dhe transferueshme;
- mbështetje për 'të mësuarit gjatë gjithë jetës';
- lidhje më të forta midis arsimit formal dhe aftësimit profesional.

Në ekonomi gjithnjë e më dinamike, rikualifikimi përbën pjesë normale të tranzicioneve profesionale. Megjithatë, niveli i lartë i gatishmërisë për rikualifikim i evidentuar në këtë studim sugjeron se, në kontekstin shqiptar, ai shpesh funksionon jo si zgjedhje strategjike zhvillimi profesional, por si mekanizëm adaptimi ndaj kufizimeve të tregut të punës dhe mungesës së stabilitetit profesional.

### **Përfundimi**

Mospërputhja midis studimeve dhe tregut të punës në Shqipëri nuk mund të shpjegohet thjesht si pasojë e zgjedhjeve individuale të gabuara, por si një problem strukturor i prodhuar nga mungesa e koordinimit midis orientimit të karrierës, sistemit arsimor dhe zhvillimit ekonomik.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e individëve zgjedhin vetë profilin e studimeve, por cilësia e kësaj zgjedhjeje kushtëzohet nga niveli i informacionit, orientimit profesional dhe mundësive reale ekonomike. Ndërsa universitetet nuk arrijnë gjithmonë të funksionojnë si mekanizma efektivë korrigjues përmes orientimit profesional, përgatitjes praktike dhe lidhjes me ekonominë reale. Paralelisht, tregu i punës mbetet i kufizuar në kapacitetin e tij për të përthithur kapitalin njerëzor të prodhuar nga sistemi arsimor, veçanërisht në rajonet me zhvillim ekonomik më të dobët.

Në këtë kontekst, devijimi profesional, rikualifikimi dhe emigrimi nuk duhet të interpretohen vetëm si zgjedhje individuale, por edhe si mekanizma adaptimi ndaj kufizimeve strukturore të sistemit.

Kukësi nuk paraqitet në këtë analizë si përjashtim apo problem periferik, por si një rast ku dobësitë ekzistuese të modelit kombëtar bëhen më të dukshme për shkak të kufizimeve më të forta ekonomike dhe profesionale. Në këtë kuptim, rajoni funksionon si një laborator analitik për të kuptuar më qartë sfidat e koordinimit midis arsimit dhe tregut të punës në Shqipëri.

Studimi sugjeron se ndërhyrjet e fragmentuara nuk janë të mjaftueshme. Përmirësimi i tranzicionit nga arsimit në punësim kërkon:

- orientim të hershëm dhe funksional të karrierës,
- universitete më të lidhura me tregun,
- mekanizma për parashikimin e nevojave të ekonomisë,
- dhe politika zhvillimore që rrisin kapacitetin e tregut të punës për të absorbuar kapitalin njerëzor.

Pa një koordinim më funksional midis këtyre hallkave, Shqipëria rrezikon të vazhdojë prodhimin e kapitalit njerëzor që nuk përputhet me nevojat reale të ekonomisë, duke e shtyrë një pjesë të konsiderueshme të të rinjve drejt përshtatjes së detyruar profesionale ose emigrimit.

Në këtë kuptim, sfida kryesore nuk është vetëm përmirësimi i zgjedhjeve individuale, por ndërtimi i një sistemi që informon më mirë, orienton më herët dhe krijon mundësi reale integrimi profesional.

#### **Referenca:**

- INSTAT (2025) *Labour Force Survey (LFS)*.
- Punësimi dhe papunësia INSTAT (2025)
- International Labour Organization. (2024). *Global Employment Trends for Youth 2024*.
- International Labour Organization. *School-to-Work Transition Surveys*.
- European Training Foundation (ETF), *Education, Skills and Employment — Trends and Developments: An ETF Cross-Country Monitoring Report, 2025*
- Organisation for Economic Co-operation and Development. (2025). *Skills Cluster: Economic Convergence Scoreboard for the Western Balkans (2025)*.